



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 30.09.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **28.09.2022** të parashtruar nga **OE Bujar Shabani B.I. & AVAG Group SH.P.K.** nga **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush”** me nr. të Prokurimit **613-22-7225-5-1-1**.

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim **OE Bujar Shabani B.I. & AVAG Group SH.P.K.** nga **Ferizaj** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush”** me nr. të Prokurimit **613-22-7225-5-1-1**

Vërtetohet Vendimi i AK i publikuara ne platformen e prokurimi i dates: 23.09.2022, i propozuar per kontrate Grupin e OE *Asphalt SH.P.K.*, & *SH.P.K NNSH WORLD MEDIUM*.

1. **Mbetet në fuqi Vendimi i AK i publikuar ne Platformen e Prokurimi** i dates: 23.09.2022.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE Bujar Shabani B.I. & AVAG Group SH.P.K. nga Ferizaj ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim; 28.09.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllövi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush” me nr. të Prokurimit 613-22-7225-5-1-1

Përgjigje për pretendimin tuaj të parë:

Tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar pika f) Cilinder gome-gome max 4T për ngjeshje të asfaltit, (min 1 cope), dhe si deshmë është kërkuar Lista e paisjeve të nënshkruar dhe vëlosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen nga pika (A - M) Deklaratat unike doganore-DUD apo faturat e blerjes së bashku me DUD doganor. Për automjetet që regjistrohen nga pika (N - T) Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me deshmë sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet dhe kohëzgjatjes të kësaj kontrate të nënshkruar dhe vëlosur nga të dyja palët

Ju si OE për këto mjet pune keni dorëzuar një dokument të leshuar nga Shteti i Holandës dhe një faturë nga kompania Izolacia dhe nuk keni ofruar deshmë sipas kërkesës së AK, në kërkesën për rishqyrtim keni bashkangjitur një dokument shtesë tjetër që nuk përket me gjuhën zyrtare sipas nenit 13 të LPP-së dhe për neve është e pakuptueshme dhe është e pa baze.

Ky pretendim i juaj është i pabazuar

Përgjigje për pretendimin tuaj të dytë:

Tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar pika r) Makinë Gjysnerimorkio speciale për vendosje të bankinave për rreth rrugëve, (min 1 cope) dhe si deshmë është kërkuar Lista e paisjeve të nënshkruar dhe vëlosur nga OE, për automjetet që nuk regjistrohen nga pika (A - M) Deklaratat unike doganore-DUD apo faturat e blerjes së bashku me DUD doganor. Për automjetet që regjistrohen nga pika (N - T) Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë OE duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me deshmë sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet dhe kohëzgjatjes të kësaj kontrate të nënshkruar dhe vëlosur nga të dyja palët.

Ju si OE për këto mjet pune keni bashkangjitur një Libreze Qarkullimi me disa të dhëna si psh. tipin e këtyre librezeve të jep “Punim Dore” tek Ndërtimi “ Makinë Punuese” dhe me nr identifikues: S19500GH dhe gjatë vlersimit në këto libreze nuk është verëzuar ndonjë emër apo diçka që deshmë për këto mjet pune dhe komisioni për vlersim të ofertave duke kërkuar me këto nr identifikues nuk ka mundur të gjejë asnjë mjet pune dmth që nuk ekziston kjo makinë e supozuar nga e juaj dhe kjo bjen në kundërshtim me kërkesën e AK, nuk mund AK, të marrë për bazë diçka që nuk ekziston me dokumentacion, dhe në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ju keni deklaruar një DUD doganor për këto mjete pune që nr identifikues nuk e ka të njëjtë dhe nëse kërkon me at nr paraqitet një mjet pune tjetër (Makinë për Bitumen) dmth në libreze të regjistrimit është nr. S19500GH kurse në Dud Doganor nr. S 19/500-GH edhe ju vetë si OE ankues mund të bëni verifikim të këtyre numrave identifikues dhe të shikoni vetë që nuk ekziston ky mjet pune.

Ky pretendim i juaj është i pabazuar

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP,


Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Data: 30.09.2022

Bekim Shabani


Drejtör i Prokurimit